

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Vahid Halili dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit K.A., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe veprës penale blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit K.A., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.253/2016, të dt.27.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 390 të KPPK, me dt.18.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të akuzuarit K.A., ndërsa aktgjykimi i të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.253/2016, e dt.27.02.2017, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.253/2016, të dt.27.02.2017, i akuzuari K.A., është shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK dhe për veprën penale nga neni 374 par.1 të KPRK, i është përcaktuar dënimi me gjobë në shumë prej 1.000(njëmijë)Euro, ndërsa për veprën penale nga neni 273 par.1 të KPRK, i është përcaktuar dënimi me gjobë në shumë prej 1.200(njëmijedyqind)Euro dhe me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite i cili nuk do të

ekzekutohet në afat prej 3(tri)vitesh, nëse i akuzuari gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale dhe në bazë të nenit 80 të KPRK, është gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej 2.200(dymijedyqind)Euro, të cilën shumë duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk paguan gjobën në afatin e caktuar dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, duke ia zëvendësuar çdo 20Euro të filluara me një ditë burgim.

Është detyruar i akuzuari që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale sado të jenë sipas llogarisë së gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga i akuzuari është konfiskuar revolva e tipit "Bereta", me numër serik V7888800, dhe sasia e marihuanës në peshë prej 4.1gr.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ankesë ka paraqitur:

-I akuzuari K.A., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet sanksion penal më i butë.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.198/2017, të dt.21.04.2017, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk është njoftuar Prokurori i Apelit, i akuzuari, meqenëse të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim me burgim.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe ankesën e të akuzuarit dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata duke shqyrtuar aktgjykimin sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, gjen se aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari ka qenë prezent, për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari mbrojtja nuk është e detyrueshme dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Pretendimet për shkak të vendimit mbi dënim dhe gjetjet e gjykatës.

I akuzuari K.A., në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, ka anashkaluar faktin se i akuzuari përherë të parë ka ardhur në konflikt me ligjin, se në anën e të akuzuarit nuk ekziston asnjë rrethanë rënduese, se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se narkotikun e ka poseduar për shfrytëzim vetanak, se armën e ka blerë si preventiv për mbrojtje, prandaj dënimi i shqiptuar është tepër i lartë, për faktin se i akuzuari ka gjendje të dobët ekonomike, prandaj konsideron se janë plotësuar kushtet që të akuzuarit ti shqiptohet dënim minimal.

Pretendimet e të akuzuarit se dënimi dhe sanksioni penal, i shqiptuar të akuzuarit janë të ashpra, është i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të sanksioneve penale pati parasysht rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, kështu si rrethanë lehtësuese të akuzuarit i ka marrë parasysht pendimin e tij për kryerjen e veprave penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo çfarëdo qofshin ato, gjendjen e dobët ekonomike, si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndërsa si rrethanë rënduese intensitetin e veprave penale dhe peshën e rëndë të tyre.

Rrethanat lehtësuese që i ka marrë parasysht gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të sanksioneve penale të akuzuarit i aprovon edhe kjo gjykatë, por jo dhe rrethanën rënduese sepse të dy rrethanat që theksohen si rrethana rënduese nga gjykata e shkallës së parë, për këtë gjykatë janë të pa kuptueshme sepse kjo gjykatë nuk kupton se çka është intensiteti i veprave penale dhe çka është peshë e rëndë e tyre, prandaj, kjo gjykatë nuk mund ti aprovoj këto konstatime si rrethana rënduese.

Pretendimet dhe theksimet e të akuzuarit K.A., në ankesë se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se është i gjendjes së dobët ekonomike, si dhe rrethanat tjera personale të

akuzuarit, janë rrethana të cilat realisht dhe drejt janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa i akuzuari në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohen sanksione penale më të buta, meqenëse i akuzuari në ankesë nuk thekson rrethana konkrete që kishin me ndikuar në shqiptimin e sanksioneve penale më të buta, atëherë kjo gjykatë gjen se pretendimi i të akuzuarit se sanksionet penale të shqiptuara janë të ashpra, janë të pabazuara.

Sipas gjetjes së kësaj gjykate sanksionet penale të shqiptuara të akuzuarit i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe sipas bindjes së kësaj gjykate me sanksionet penale të shqiptuara të akuzuarit edhe atë me dënim me gjobë dhe me gjykim me kusht ndaj të akuzuarit, do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 41 të KPRK, e që është që të parandaloj të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale dhe të ndikoj në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, si dhe qëllimi i dënimit me kusht i paraparë në nenin 50 të KPRK, e që është që të mos zbatohet dënimi kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënim me dënim është e nevojshme të ndaloj të akuzuarin të mos kryej vepër penale.

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.199/2017, të datës 18.05.2017

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit:

1.Vahid Halili

2.Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit,

Fillim Skoro
